



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 597 / Prot. 01

Datë 15.05.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lezhë

Drejtuar: Z. Fran FRROKAJ
Kryetar
Bashkia Lezhë

Për dijeni: Operatori ekonomik UTS-01 shpk
Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rr. "Nikolla Jorga", Nd. 7, H. 7, Ap. 42,
Tiranë

I nderuar Z. Frrokaj,

Në vijim të shkresës Tuaj, Nr. 3239 Prot., datë 25.04.2017, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 597 Prot., datë 02.05.2017, me lëndë: "Kërkesë për kontrollin e përputhshmërisë së draftit të PPV-së Bashkisë Lezhë", AKPT ka kryer kontrollin e përputhshmërisë sipas legjislacionit të planifikimit dhe atij sektorial të materialit në CD bashkëlidhur shkresës Tuaj.

Sipas VKM Nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit": "AKPT-ja kryen shqyrtimin e përputhshmërisë së dokumentacionit brenda 15 ditëve nga data e botimit dhe e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë."

Dokumentacioni i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lezhë, është e nevojshme të botohet i plotë në Regjistrin e Integruar të Territorit, ndërkohë që materiali i dorëzuar në rrugë shkresore është i mangët në informacion, dhe duhet të plotësohet në respektim të përmbajtjes së PPV-së sipas Rregullores së Planifikimit.

Nga dokumentacioni i dorëzuar, mbi dokumentin *Perdorimi i tokës*, jepen komentet si vijon:

1. Njësia e propozuar me përdorim "S – shërbim", me kod SHGJ-UB-132, që prek Lagunën e Merxhanit, Zonë e Përdorimit Tradicional pjesë e Zonës së Mbrojtur Kune-Vain-Tale, dhe njëkohësisht trupin uJOR të lagunës, duhet të rishikohet, për të respektuar legjislacionin sektorial përkatës dhe të sipërcituar, duke reflektuar përdorimin në përputhje, "N – natyrë" dhe "U-Ujëra".

2. Rikujtojmë që Brezi Bregdetar është Zonë e Rëndësisë Kombëtare, pjesët e orientuara për zhvillim territorial të të cilit duhet t'i nënshtrohen hartimit të Planeve të Detajuara të Zonave të Rëndësisë Kombëtare.

Me botimin në regjistër e dërgimin e PPV-së së plotë për Bashkinë Lezhë, dhe reflektimin së paku të çështjeve të listuara më sipër, AKPT do të angazhohet për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë, në mënyrë që të vijohet me miratimin e PPV-së në Këshillin Bashkiak, dhe Këshillin Kombëtar të Territorit.

Me respekt,

Adelina GRECA



DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi, punoi: F. Mah

Datë: 15.05.2017

Nr. Kopje: 3

